



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

UNIVERSITY OF PRIZREN

„Ukshin Hoti“

Rektorati

---

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

---

Nr. i ref. 01- 1345

Prizren, më 3.10.2014

---

**Senati i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", në mbledhjen e mbajtur më 03.09.2014 mori Vendim për shpalljen e**

### **KONKURSIT**

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve pasdiplomike - master për vitin akademik 2014-2015**

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", për studimet pasdiplomike - Master, për vitin akademik 2014 - 2015 do të regjistrojë **180** student në këto Fakultete ;

- I. Në Fakultetin Ekonomik, në drejtimin Administrim Biznesi - 60 studentë
- II. Në Fakultetin Ekonomik, në drejtimin Kontabilitet dhe Auditim - 60 studentë
- III. Në Fakultetin e Shkëncave Kompjuterike në drejtimin: Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi - 60 studentë

### **KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURSIT**

Në studimet pasdiplomike - Master do të pranohen kandidatët të cilët i kanë përfunduar studimet Bachelor apo ato para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në fakultetet përkatëse të Universitetit Publik të Prizrenit "Ukshin Hoti" apo të Universiteteve tjera, e që kanë arritur notën mesatare 7.50 e më lart. Përzgjedhja e këtyre kandidatëve bëhet sipas ranglistës prioritare të notës mesatare të arritur gjatë studimeve.

Në rast kur numri i kandidatëve është më i vogël se numri i paraparë me konkurs, atëherë mund të pranohen edhe kandidatë me notë mesatare më të ulët se 7.50, por ata do t'i nënshtrohen provimit pranues të përgatitur nga Komisioni i Studimeve i njësisë akademike.

### **AFATET KONKURSIT**

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve oraret do të jenë si në vijim:

**Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 07.10.2014 deri më 15.10.2014 në ora 16.00 (dokumentet do të pranohen vetëm ditëve të punës). Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**

- Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për aplikim Online përmes Internetit është: <http://notimipz.uni-pr.edu/aplikimionlinemaster.aspx>**
- Çertifikatën e datëlindjes me numër personal
- Diplomën-certifikatën e kryerjes së fakultetit
- Pasqyrën e provimeve të dhëna me notë mesatare për studentet nga Universitetet tjerë.
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Kandidatët me rastin e paraqitjes paguajnë **2.5** euro(fletëpagesa shkarkohet nga interneti me rastin e aplikimit)  
**Provimi pranues do të mbahet më 17.10.2014 nga ora 9:00**

**Shpallja e rezultateve të provimit pranues bëhet më date 20.10.2014**

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri (3) ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve.